

Tiranë më 18.08.2022

## KËRKESË

Drejtuar: **Z. EDI RAMA**  
**KRYEMINISTËR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**ZNJ. ELVA MARGARITI**  
**MINISTRE E KULTURËS**

I Nderuar Z. Kryeministër,

E Nderuar Znj. Ministre e Kulturës,

Disa ditë më parë, trupa artistike e Teatrit Kombëtar konstatoi me kënaqësi të madhe se trupës artistike (*dhe jo vetëm*) të Teatrit Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansambilit Popullor (TKOBAP), i është rritur paga nga 15%-57%. U gëzuam për kolegët tanë dhe njëkohësisht u hidhëruam pa masë për veten tonë. Është hera e parë në historinë e këtij vendi që këto dy institucione kombëtare trajtohen në mënyrë të diferencuar. Në mënyrën se si funksionon dhe si është ndërtuar sistemi i pagave, këto institucione janë vlerësuar gjithmonë brenda një kuadri ligjor. Në këtë rast, me ndërhyrjen e Këshillit të Ministrave, kjo gjë ndryshoi dhe TKOBAP kategorizohet në një system të ri pagash, kurse TK jo! E papranueshme! Ende nuk është dhënë një shpjegim publik për këtë.

Ndërkohë, ju bëjmë me dije se, Teatri Kombëtar, gjithë këto vite, ka qenë pararojë e institucioneve publike të artit. Në sezonet 2016/17 dhe 2017/18, TK, në kalendarin e tij, ka qenë në krye të renditjes për nga frekuentimi i spektatorëve. Më pas, me gjithë vështirësite që u krijuan, që nga 'beteja' për Teatrin, prishja e godinës së vjetër të TK-së, spostimi te ArTurbina dhe pandemia, ne sot po ja arrijmë përsëri, falë një pune të jashtëzakonshme, të mbushim plot e përplot sallën e ArTurbina. Këtë sezon artistik *'post-pandemik'*, kemi marrë pjesë dhe kemi interpretuar në produksione shumë të mëdha e të vështira, ku mund të përmendim: "Coriolanus" nga U.Shekspir, "Edmond" nga A.Mishalik, "Ferma e Kafshëve" nga Xh.Oruell, "Përvjetori i Diëlindjes" nga D.Eldrixh. Kanë nisur dhe provat për produksionin "Ivanov" nga A.Çehov. Këto janë vepra të mëdha që kërkojnë një punë të jashtëzakonshme, ku një pjesë e madhe e aktorëve, veç provave, interpretojnë çdo javë, nga e mërkura në të diel, dhe e mbyllin sezonin me rreth 40-50 shfaqje. Atëherë pse ky diskriminim, Z.Kryeministër?

Gjithsesi, ne do të dëshironim që kjo të jetë thjesht çështje kohe dhe ky vendim të miratohet edhe për ne, së shpejti, me buxhetin e ri të shtetit, ku do presim të parashikohet ngritja e pagës dhe për institucionin tonë. Të bindur për këtë, me durim do presim reagimin tuaj deri më 31 Gusht 2022. Nëse pastaj do vëmë re që kjo gjë do të kalojë në indiferencë, pra është bërë qëllimisht, atëherë ne do të përshkallëzojmë dhe veprimet tona për të mbrojtur dinjitetin njerëzor dhe artistik.

Qëndrojmë në pritje të përgjigjes tuaj.

Me respekt,

Laert Vasili

Dritan Borici

Dori Gauski

Arben Berkuçi

Ota Doku

Besmir Bitraku

Amila Bisla

Donald Skellu

Ardian Ceryu

Diada Soliosi

Mohriçim Xhepa

Ima Gjorgji

Julzim Zeqja

Melidon Had

LAEDIA HADIDARI

Armanut DORJA

Luçia Bati

Flaura KURTA

Ella Zaharie

GLADIORA HARIZAT

Nanna Shundi

Erjona Kokeli

MYZEFER ZATA

18.08.2022